

**SHOQATA E GRAVE TË POLICISË SË KOSOVËS**

**STRATEGJIA OPERATIVE E  
SHOQATËS SË GRAVE TË POLICISË SË KOSOVËS  
2013 – 2015**

**Përkrahur nga UN Women**

# HYRJE

---

Ky dokument paraqet Strategjinë Operative të Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës, për periudhën 2013 – 2015 dhe duhet të jetë një bazë mbi të cilën punohet në realizimin e qëllimeve të shoqatës. Ky dokument është fleksibil dhe duhet t'i përshtatet rrethanave dhe mundësive të Shoqatës për kohën dhe mundësinë e implementimit të projekteve me qëllim të arritjes së objektivave të cekura.

Themelimi dhe puna e Shoqatës së Grave të Policisë të Kosovës është e mbështetur fuqishëm nga UN Women, e cila mbështet zhvillimin e kapaciteteve të Shoqatës së Grave Police të Kosovës duke avokuar dhe lobuar për mëshitetjen e tyre nga instanca të ndryshme, dhe duke ofruar përkrahje direkte në zhvillimin e shoqatës.

Grupi i SH.G.P.K-së është fokusuar në pesë fusha strategjike që paraqesin edhe pesë shtyllat programore të Shoqatës. Në vijim do të paraqitet puna nga grupet në secilin hap dhe Kornizat Logjike për secilën prej shtyllave programore të SH.G.P.K-së.

Qëllimi i Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës është krijimi i një shoqate përkrahëse të barazisë gjinore dhe kontributit të vlefshëm që gratë police japin për të siguruar llogaridhënie, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe çështjeve të sigurisë si të grave ashtu dhe të burrave. Misioni i Shoqatës ka të bëjë me fuqizimin e rolit dhe pozitës së Gruas në Policinë e Kosovës, vetëdijesimin mbi çështjet që prekin gratë, promovimin e barazisë gjinore, zhvillimin profesional dhe promovimin ndërkombëtar të shoqatës dhe grave police të Kosovës.

Duke u bazuar në Qëllimet e Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës filloi puna në identifikimin/ rishqyrtimin e fushave të veprimit të SH.G.P.K-së, fusha të cilat u klasifikuan në pesë drejtime kryesore të veprimit të cilat do të shërbejnë edhe si pesë shtyllat kryesore strategjike të Shoqatës në veprimtarinë e saj. Fushat janë si vijon:

1. Ngritja e vetëdijes dhe adresimi i çështjeve në interes për gratë në kuadër të Policisë së Kosovës dhe shoqërisë
2. Promovimi dhe ndihma në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit në Policinë e Kosovës
3. Përkrahja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të grave në Policinë e Kosovës
4. Pjesëmarrja në rrjetet dhe nismat profesionale dhe sociale në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar
5. Promovimi dhe mbrojtja e mirëqenies shëndetësore dhe psiko-sociale të grave në Policinë e Kosovës

# ANALIZA E PROBLEMEVE

---

Problemet e adresuara në Strategjinë Operative janë analizuar nga këndvështrimi i pesë fushave të përzgjedhura të operimit. Problemet e identifikuar shërbejnë si indikator për drejtimet e intervenimeve të nevojshme dhe për përcaktimin e objektivave të Strategjisë Operative.

Fusha e parë është përqendruar në paraqitjen e problemeve që janë të lidhura me vetëdijen e ulët mbi parimet e barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit në Policinë e Kosovës. Disa nga shkaqet kryesore të identifikuar me këtë problem në fokus ndërlidhen me çështjen e pjesëmarrjes së ulët të grave në pozita vendimmarrëse në Policinë e Kosovës si një ndër shkaqet më me ndikim. Një shkak tjetër i ndërlidhur është edhe zhvillimi i ulët profesional i grave në PK për sa i përket trajnimeve të specializuara dhe arritjes së ndikimit përmes procesit të emërimeve. Mos informimi i mjaftueshëm mbi barazinë gjinore dhe mos-diskriminimin në PK si çështje parimore po ashtu u identifikua si një problem kyc. Më tutje, paragjykimet shoqërore mbi rolin dhe pozitën e femrës janë parë se luajnë një rol të rëndësishëm në vetëdijen e ulët mbi këto çështje. Fusha e dytë është përqendruar në paraqitjen e problemeve të ngjajshme me fushën e parë që kanë të bëjnë me moszbatimin e parimeve të barazisë gjinore dhe rastet e diskriminimit në Policinë e Kosovës. Vëmendja është përqendruar tek gratë dhe vetëdijesimi për të drejtat e tyre, ofrimi i mundësive për ngritje të zërit me rastin e ballafaqimit me situata komplekse. Shkaqet e tjera lidhen me vetëdijen e ulët mbi barazinë gjinore, që është trajtuar nga grupi 1, derisa si një problem shkaktar kyç ndërlidhet me përkrahjen e pamjaftueshme nga stafi menaxhues i Policisë së Kosovës.

Përqendrimi i fushës së tretë është vendos në zhvillimin profesional të grave në Policinë e Kosovës. Pamjaftueshmëria e përkrahjes nga Policia e Kosovës, si dhe dominimi i mentaliteti patriarkal në familje paraqet problem në nxitjen / vullnetin e grave në Policinë e Kosovës për avancim profesional brenda Policisë. Këtu janë theksuar problemet në ofrimin e mundësive për trajnime profesionale dhe emërimet të grave në kuadër të Policisë së Kosovës. Poashtu, përkrahja e kufizuar nga menaxhmenti i PK-së është përmendur si një problem shkaktar.

Fusha e katërt ka përqendruar vëmendjen në mungesën e përfaqësimit/anëtarësimit të grave të Policisë së Kosovës në rrjetet profesionale dhe iniciativat në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Disa nga problemet e ndërlidhura me këtë rast janë pamjaftueshmëria e fondeve, mungesa e kontakteve me organizatat simotra, mungesa e iniciativës nga Policia e Kosovës dhe prioritetet tjera në Policinë e Kosovës, si dhe mungesa e strategjisë për promovim ndërkombëtar ndër tjerash. Krijimi i Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës është theksuar si një hap i mirë që mundëson trajtimin e problemit në fokus.

Vëmendja e fushës së pestë është përqendruar në rastet e përkrahjes së pamjaftueshme lidhur me çështjet shëndetësore dhe psikologjike të grave brenda Policisë së Kosovës. Theksi është vënë në zbatimin e kufizuar të legjislacionit dhe procedurave të Policisë së Kosovës lidhur me shëndetin e grave; shkallën e ulët të parandalimit të sëmundjeve, si dhe kushtet e rënda të punës me rastet e shtatzënive, sëmundjeve kronike, kërkesave për higjienë ndër tjerash.

# STRATEGJIA OPERATIVE

---

Strategjia operative është zhvilluar në baza programore (fushat e veprimit) dhe është prezentuar në formë të Kornizave Logjike. Kjo përfshin programet (Kornizë Logjike e veçantë për secilin program), objektivat specifike në kuadër të programeve, aktivitetit, indikatorët e rezultateve të pritura, qëllimin dhe objektiven e përgjithshme të secilit program, të cilat paraqesin vizionin e Shoqatës në rastin e strategjisë së SH.G.P.K.

Grupet kanë punuar në zhvillimin e pesë Kornizave Logjike për pesë shtyllat kryesore programore të Shoqatës. Këto korniza duhet të kuptohen si pjesë integrale e veprimtarisë së SH.G.P.K-së dhe si të tilla komplementare në arritjen e Vizionit të Shoqatës. Këtu ka një numër projektsh/aktivitetesh, të paraqitura në shtyllën e Logjikës Intervenuese si aktivitete, të cilat janë të ngjashme apo të njëjta në disa nga Kornizat e grupeve të tjera punuese. Këto duhet kuptuar si aktivitet i njëjtë dhe i vetëm, i cili kontribuon në arritjen e disa objektivave njëkohësisht.

Strategjia operative në këtë dokument është e paraqitur përmes Logjikave Intervenuese për secilën Fushë të Veprimit. Të gjitha intervenimet e planifikuara të kuadër të pesë Kornizave Logjike kontribuojnë në arritjen e objektivave, misionit dhe vizionit të Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës.

Më poshtë janë të paraqitura Logjikat Intervenuese për secilën fushë të veprimit të SHGPK, të cilat paraqesin planin e veprimit afatmesëm të Shoqatës. Strategjia Operative e Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës (SH.G.P.K) duhet të shërbejë si bazë për zhvillimin e programeve vjetore të SH.G.P.K -së.

**Logjika Intervenuese – Grupi 1 – Vetëdijesimi për barazi gjinore dhe çështjet me interes për gratë në Policinë e Kosovës**

	LOGJIKA INTERVENUESE		
<b>OBJEKTIVA E PËRGJITHSHME</b>	Fuqizimi i rolit dhe pozitës së grave në Policinë e Kosovës		
<b>QËLLIMI SPECIFIK</b>	Vetëdijesimi mbi barazinë gjinore dhe çështjet me interes për gratë në Policinë e Kosovës	-	-
<b>REZULTATET E PRITURA</b>	<b>1. Informimi i shtuar në publik mbi barazinë gjinore</b>	<b>2. Ngritja e njohurive mbi barazinë gjinore dhe çështjet me interes për gratë në Policinë e Kosovës</b>	<b>3. Ngritja e përfaqësimit të grave në pozita vendimmarrëse</b>
<b>AKTIVITETET</b>	1.1 Fushatat mediale në baza 3-mujore	2.1 Vlerësimi i nevojave mbi njohuritë për barazi gjinore (hulumtim)	3.1 Inkurajimi i femrave për aplikim/rekrutim në Policinë e Kosovës
	1.2 Fushatat promovuese në baza 6-mujore (material i shtypur)	2.2 Identifikimi dhe certifikimi i trajnerëve	3.2 Motivimi për avancim në karriere përmes takimeve / trajnimeve (role models)
	1.3 Vetëdijesimi i shoqërisë për rolin e femrës dhe barazisë gjinore	2.3 Hartimi i programit të trajnimit sipas nivelit menaxhues	3.3 Organizimi i trajnimeve të veçanta për pozita menaxhuese
	-	2.4 Realizimi i trajnimeve	3.4 Ofrimi i mundësive për shkollim të lartë (përfshirë edhe programe të bursave për shkollim jashtë vendit)
	-	-	3.5 Shqyrtimi i kushteve të punës në rastet e transfereve pas avancimit
	-	-	3.6 Shqyrtimi i rasteve të dorëheqjeve
	-	-	3.7 Vetëdijesimi dhe inkurajimi për raportimin e ngacmimeve seksuale
	-	-	3.8 Programet e specializuara për lidërsip

**Logjika Intervenuese – Grupi 2 – Promovimi dhe ndihma në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit në Policinë e Kosovës**

	LOGJIKA INTERVENUESE		
<b>OBJEKTIVA E PËRGJITHSHME</b>	Fuqizimi i rolit dhe pozitës së grave në Policinë e Kosovës		
<b>QËLLIMI SPECIFIK</b>	Zbatimi i plote i parimeve të barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit në Policinë e Kosovës	-	-
<b>REZULTATET E PRITURA</b>	<b>1. Përkrahja më e madhe nga stafi menaxhues</b>	<b>2. Ngritja e vetëbesimit të grave në Policinë e Kosovës</b>	<b>3. Mbrojtja institucionale kundër pabarazisë dhe diskriminimit të grave</b>
<b>AKTIVITETET</b>	1.1 Kampanjat e ndryshme mediale/ fletushkat, për vetëdijesimin e dy palëve për barazi (edukimi, shkollimi në frekuencë çdo gjashtë muaj në 3 vitet e para të verpimit të shoqatës)	2.1 Promovimi i shoqatës, misionit dhe i veprimit të saj	3.1 Krijimi i komitetit punues të Shoqatës për angazhim kundër diskriminimit dhe pabarazisë
	1.2 Takimi dhe ngritja e kërkesave për barazi gjinore drejtuar menaxhmentit (avokimi)	2.2 Organizimi i takimeve / punëtorive me gratë e Policisë së Kosovës nëpër regjione	3.2 Informimi i grave në Policinë e Kosovës mbi ekzistimin dhe rolin e komitetit
	1.3 Avokimi për përfshirjen e së paku një femre në nivel ekzekutiv	2.3 Promovimi i rasteve të suksesshme përmes revistës, broshurës, Ueb-faqes	3.3 Të sigurohet e drejta e komitetit për të monitoruar punën e bordit të ankesave
	1.4 Analiza e legjislacionit për barazi gjinore dhe avokimi për avancim të të drejtave	2.4 Publikimi i një doracakut mbi të drejtat e grave	3.4 Trajnimi i anëtarëve të komitetit mbi të drejtat ligjore
	-	-	3.5 Mbledhja dhe publikimi i statistikave periodike mbi rastet e pabarazisë dhe diskriminimit
	-	-	3.6 Identifikimi nga praktika e zbatimeve ligjore dhe procedurave
	-	-	3.7 Etablimi i një protokollit bashkëpunimi mes shoqatës dhe ombudspersonit

**Logjika Intervenuese – Grupi 3 – Përkrahja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të grave në Policinë e Kosovës**

	LOGJIKA INTERVENUESE	
<b>OBJEKTIVA E PËRGJITHSHME</b>	Fuqizimi i rolit dhe pozitës së grave në Policinë e Kosovës	
<b>QËLLIMI SPECIFIK</b>	<b>Ngritja e shkallës së edukimit profesional</b>	-
<b>REZULTATET E PRITURA</b>	<b>1. Përkrahja e shtuar për gratë në Policinë e Kosovës nga menaxhmenti</b>	<b>2. Mundësitë e shtuara për zhvillim profesional të grave në Policinë e Kosovës</b>
<b>AKTIVITETET</b>	1.1 Organizimi i lojërave sportive dhe aktiviteteve te ndryshme promovuese për pozitën e grave	2.1 Sigurimi i bursave për shkollim universitar
	1.2 Mediat, konferencat e ndryshme, broshurat	2.2 Arritja e marrëveshjeve me institucionet e arsimit te larte
	1.3 Inkurajimi aktiv për aplikimin e grave në pozita udhëheqëse në Policinë e Kosovës dhe akvokimi te menaxhmenti i lartë	2.3 Përgaditja dhe zbatimi e programeve te dizajnuara për lidership / menaxhment
	-	2.4 Krijimi i mekanizmave të rregullt në bazë regjionale për përgatitjen / ndihmën e grave police për teste në procesin e emërimeve (mentorimi, bursa)
	-	2.5 Mos-diskriminimi i grave në emërimet për pozita të larta – Avokim dhe lobim.
	-	-



**Logjika Intervenuese – Grupi 4 – Pjesëmarrja në rrjetet profesionale dhe iniciativat në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar**

	LOGJIKA INTERVENUESE		
<b>OBJEKTIVA E PËRGJITHSHME</b>	Fuqizimi i rolit dhe pozitës së grave në Policinë e Kosovës		
<b>QËLLIMI SPECIFIK</b>	Anëtarësimi në rrjetet profesionale dhe iniciativat në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar	-	-
<b>REZULTATET E PRITURA</b>	<b>1. Themelimi i shoqatës së grave në Policinë e Kosovës</b>	<b>2. Funkcionalizimi i shoqatës së grave në Policinë e Kosovës</b>	<b>3. Hartimi i planit për anëtarësim në rrjetet profesionale</b>
<b>AKTIVITETET</b>	1.1 Mbajtja e kuvendit themelues të SHGPK	2.1 Zgjedhja e kryesisë dhe presidentit, si dhe komiteteve punuese	3.1 Caktimi i grupit punues për hartim të planit
	1.2 Aprovimi i statutit	2.2 Marrëveshje mirëkuptimi mes shoqatës dhe Policisë së Kosovës	3.2 Hartimi dhe aprovimi i planit të veprimit për anëtarësim
	1.3 Regjistrimi i shoqatës	2.3 Hartimi i rregulloreve për funksionim të bordit dhe kuvendit	3.3 Vendosja e kontakteve kombëtare-ndërkombëtare
	-	2.4 Sigurimi i fondeve	3.4 Aplikim për anëtarësim në nisma dhe konferenca të ndryshme
	-	-	3.5 Organizimi i konferencës ndërkombëtare në Kosovë për gratë Police
	-	-	3.6 Vizita studimore bilaterale me shoqata simotra
	-	-	3.7 Përcaktimi i kritereve për përzgjedhjen e përfaqësuesve të shoqatës në forume

**Logjika Intervenuese – Grupi 5 – Promovimi dhe mbrojtja e mirëqenies shëndetësore dhe psiko-sociale të grave në Policinë e Kosovës**

LOGJIKA INTERVENUESE				
<b>OBJEKTIVA E PËRGJITHSHME</b>	Fuqizimi i rolit dhe pozitës së grave në Policinë e Kosovës			
<b>QËLLIMI SPECIFIK</b>	Mirëqenia e plotë shëndetësore dhe psiko-sociale e gruas në Policinë e Kosovës	-	-	-
<b>REZULTATET E PRITURA</b>	<b>1. Niveli më i lartë i njohurive mbi legjislacionin për mbrojtjen e grave në Policinë e Kosovës</b>	<b>2. Zbatimi i plotë i legjislacionit dhe procedurave për mbrojtjen e grave në Policinë e Kosovës</b>	<b>3. Zvogëlimi i rasteve të sëmundjeve të parandalueshme dhe sëmundjeve specifike të grave</b>	<b>4. Krijimi i ambientit më të mirë për punë</b>
<b>AKTIVITETET</b>	1.1 Organizimi i fushatave, publikimi i fletushkave, mbajtja e ligjëratave	2.1 Përfundimi i punës në legjislacion sekondar/ udhëzimet administrative	3.1 Ekzaminimet mjekësore	4.1 Bashkëpunimi me menaxhmentin për respektimin e nevojave të veçanta
	1.2 Publikimi i legjislacionit mbi të drejtat e grave dhe mbrojtjen shëndetësore në Ueb-faqen e shoqatës	2.2 Avokim dhe Lobim për aprovimin e PSO-ve për mbrojtje shëndetësore	3.2 Vaksinimet	4.2 Lobimi për kushte të veçanta në punë për gratë në PK (aspekti higjienik)
	1.3 Organizimi i punëtorisë mbi legjislacionin gjinor për eproret e Policisë së Kosovës	-	3.3 Mbajtja e seancave psikologjike	-
	-	-	3.4 Ndihma profesionale mjekësore	-
	-	-	3.5 Blerja e pajisjeve për ekzaminime mjekësore	-
	-	-	3.6 Aktivitete të edukimit shëndetësor	-